

PERMBLEDHJE E RISHIQIMIT MJEDISORE DHE SOCIAL (ESRS) PROJEKTI: HIB Petrol

Mohimi

Kjo përmbledhje e rishiqimit mjedisorë dhe social (ESRS) është përgatitur dhe shpërndarë përpara bordit të Drejtorëve të IFC me qëllim të shqyrtimit të ujdisë së propozuar. Qëllimi i këtij projekti është që të rris transparencën e aktiviteteve të IFC-së dhe ky dokument duhet të ndërtohet mbi supozimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve të IFC-së. Datat e bordit janë vetëm vlerësime. Të gjitha dokumentet e bashkangjitura me ESRS janë përgatitur nga sponzori i këtij projekti dhe janë autorizuar publikisht. IFC i ka shqyrtuar të gjitha dokumentet dhe ka konsideruar që kanë qenë të kualitetit adekuat për lëshim në publik mirëpo nuk e vërteton përmbajtjen e tyre.

Përshkrimi i projektit:

HIB Petrol (“HIB” apo “kompania” - <http://hibpetrol.com/>) është themeluar në vitin 1990 si kompani për tregëtimin e naftës dhe derivateve të saj, tani është rritur për të qenë njëra nga kompanitë më të mëdha në Kosovë. Shitjet e HIB Petrol janë të ndara në tri linja biznesore si vijonë: (i) 55% nga shitjet me shumicë së bashku me deponinë, ku HIB Petrol ka kontrata afatgjate me mbi 300 stacione të naftës si dhe me disa nga institucionet më të mëdha qeverisëse vendase si dhe organizata ndërkombëtare; (ii) 45% nga furnizimi me pakicë nga 13 stacione të derivateve në territroin e Kosovës; dhe (iii) 5% nga hoteli i bukur me 72 dhoma i pajisur me salla të përshtatshme për për evente.

Investimi i propozuar nga IFC është që të financoj zgjerimin e HIB Petrolit me (1) dy stacione të reja të derivateve (iii) shitimi 45 dhomave dhe një qendre të konferencave/restaurant për hotelin ekzistues.

Deponia ndodhet në një zonë industriale e rrethuar nga deponi të industrive të tjera. Të gjitha stacionet e derivateve ekzistuese si dhe ato të planifikuara janë përgjatë autostradave kryesore pranë të cilave nuk ka asnjë komunitet rezidencial. Hoteli I HIB gjithashtu operon përgjatë autostradës që nga viti 2004 në Prishtinë, Kosovë. Zgjerimi i propozuar do të zbatohet pranë hotelit ekzistues në tokën që e posedon kompania.

Përmbledhja e fushëveprimit të IFC'së

Rishiqimi i këtij projekti ka të bëjë me vlerësimin teknik, mjedisorë, shëndetësorë të sigurisë (EHS) si dhe informatat shoqërore të paraqitura nga kompania që përfshijnë dokumentacionin në lidhje me shitjen e derivateve me shumicë, me pakicë, ato logjistikë, të menaxhimit të hotelit, rregulloren dhe procedurat e EHS-së së korporatës, sistemit të menaxhimit të EHS-së së korporatës, rregulloren e burimeve njerëzore të korporatës, angazhimin e palëve të interesuara, menaxhimin e sigurisë etj të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar gjatë vlerësimit. Ekipi i vlerësimit mjedisorë dhe social (E&S) gjithashtu kanë bërë vlerësimin mjedisorë dhe social të komunikuar në gjuhën angleze. Ekipa e E&S gjithashtu vizituan zyret qendrore të HIB në Prishtinë, Kosovë si dhe depon e derivateve të HIB, 3 stacione të derivateve dhe hotelin gjatë datave 16-17 Janar 2017. Ekipa e E&S gjithashtu ka mbajtur takime me menaxhmentin e korporatës, të deponisë si dhe të hotelit, përveq kësaj ka intervistuar stafin punues në depon e derivateve si dhe në hotel.

Standardet e identifikuara e të përcaktuara të performancës:

Përderisa të gjitha standardet e performancës janë të aplikueshme në këtë investim, kujdesi mjedisorë dhe shoqërorë i IFC-së tregon se investimi do të ketë ndikime të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me Standardet e mëposhtëme të performancës

PS1: Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimit të rreziqeve mjedisore dhe sociale

PS2: Kushtet e punës dhe të klasës punëtore

¹ Sentences in italics are standard language and cannot be modified.

PS3: Eficienca e burimeve si dhe parandalimi i ndotjes

PS4: Siguria mbi shëndetin e komunitetit

Stacionet e reja të derivateve dhe zgjerimi i hotelit do të ndërtohen përmes rrugëve kryesore kombëtare. Pjesët e tokës të parapara për hapjen e stacioneve të derivateve janë të vogla dhe të blera individualisht nga pronarët e tokave përmes procesit të vullnetit të lirë të shit-blerjes. Ngjashëm edhe zgjerimi i hotelit do të bëhet në tokën ekzistuese të zotëruar nga kompania që nga viti 2004. Rivendosje të pavullentshme nuk do të ketë për shkak të projektit. Prandaj PS5: Blerja e tokës dhe zhvendosja e vullnetshme, PS6: Konservimi dhe menaxhimi i Burimeve Jetësore të qëndrueshme, PS7: Popujt vendas, si dhe PS8: Trashëgimia kulturore konsiderohet të jenë të pazbatueshme për projektin.

Nëse investimet e IFC-së vazhdojnë, IFC do të rishikojë vazhdimisht nëse projekti është duke u kryer në përputhje me standardet e performancës.

Arsyetimi mbi kategorizimin Mjedisorë dhe Social:

Projekti përfshinë shpërndarjen e derivateve më shumicë dhe me pakicë dhe zgjerimin e hotelit, emetimet/derdhjen e mbeturinave apo të mbetjeve janë të kufizuara. Të gjitha stacionet e derivateve të ndërtuara viteve të fundit janë në toka jo-industriale, ato janë ndërtuar nën korniza strike të sigurisë. Rreziqet kryesore të E&S lidhur me projektin përfshijnë: kapacitetin e kompanisë si dhe sistemin e menaxhimit për të menaxhuar dhe për të asistuar në mënyrë adekuate mbi ndikimet e operacioneve të E&S, kushtet e punës duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë në vendet e punës (OHS), eficienca si dhe menaxhimi i mbetjeve dhe emetimeve nga deponia e derivateve, stacioneve të derivateve si dhe nga hoteli përkitazi me kërkesat e aplikueshme me World Bank Group nga direktivat e EHS, jeta dhe siguria mbi zjarrin në hotel si dhe ndikimet e infrastrukturës për shpërndarjen e karburantit.

Masat zbutëse për ndikimet potenciale të E&S janë identifikuar dhe janë inkorporuar në Planin të Veprimit Mjedisorë (ESAP). Ndikimet e mundshme negative të E&S të këtij projekti konsiderohen të pakta në numër, me rëndësi të kufizuar si dhe lehtësisht të zbutura përmes sistemeve dhe procedurave ekzistuese të qëndrueshme të kompanisë. Prandaj ky është projekt i kategorisë B sipas rregulores së Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të IFC's.

Masat zbutëse Mjedisore dhe Sociale

IFC ka marrë parasysh procesin e planifikimit dhe të menaxhimi social, dokumentacionin për projekt si dhe nëse ka hapsira në mes të tyre dhe kërkesave të IFC'së. Aty ku është e nevojshme masat korrektuese mundohen ti mbyllin hapsirat brenda një periudhe të arsyeshme kohore, ato përmbledhen në paragrafe (gjithmonë nëse janë të aplikueshme) dhe të pajtuara me Planin për veprim Social (EASP). Përmes implemtentimit të këtyre masave projekti pritet të dizajnohet dhe të operoj në përputhje me Standardet dhe objektivat e Performancës.

PS 1 – Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimit të rreziqeve Sociale dhe mjedisore

Sistemi i menaxhimit, vlerësimi mjedisorë dhe social

Të gjitha projektet e HIB-it janë të vogla. Sipas rregulloreve lokale, HIB ofron dokumentacionin e nevojshëm për analizën e E&S si dhe për zbutjen e rreziqeve. Autoritetet vendore do të shqyrtojnë dokumentacionin kundër rregullimit përkatës dhe do të kryejn inspektimin përkatës para se të

lëshojnë lejen për E&S. HIB Petroli ka detajizuar kërkesat mjedisore OHS, të sigurisë ndaj zjarrit dhe të burimeve njerëzore në programin e menaxhimit të E&S. Për projektin e propozuar standardet e zbatueshme të performancës të IFC-së si dhe Udhëzimet e WBG-së do të zbatohen në operacionet e vlerësimit të rrezikut të E&S.

Politika:

HIB Petrol përdorë një politikë korporative të E&S e cila ka për qëllim ruajtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit ku vepron përmes profesionalizimit dhe drejtësisë në shërbimet që ofron. Politika e HIB siguron që operacionet me të cilat veprojnë të mos kenë ndikime negative në ambientin e veprimit apo në komunitet. Punonjësit e rinj trajnohen në kornizat e politikës korporative E&S gjatë orientimit të tyre në punën e re.

Identifikimi dhe ndikimi i rreziqeve:

HIB monitoron rreziqet mjedisore dhe sociale për stacionet e reja të derivateve, ato regjistrohen sipas rregulloreve lokale. Për të minimizuar rreziqet potenciale që lidhen me ndotjet historike HIB nuk blen stacione të vjetra të derivateve apo toka industriale. Të gjitha stacionet e reja të derivateve janë të vendosura përgjatë autostradës kryesore si dhe larg zonave të banuara.

HIB Petrol ka kontraktuar ekspert të jashtëm për të audituar menaxhimin e Burimeve Njerëzore karshi kërkesave, rregulloreve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Si pjesë e këtij programi HIB do të zgjerojë auditimin e jashtëm në një program vjetor të auditimit të EHS-së kundrejt rregulloreve lokale dhe kërkesave të zbatueshme të Standardeve të Performancës së IFC-së, World Bank Group (WBG), udhëzimeve të EHS si dhe praktikave të tjera të mira të kësaj industrie. Programi do të përfshijë auditimet e jashtme dhe të brendshme të EHS-së si dhe të Burimeve Njerëzore.

Programi i menaxhimit:

Kompania ka dokumentuar procedurat standarde operacionale (PSO) me role dhe përgjegjësi të përcaktuara mirë si dhe me kërkesa për trajnimin e menaxhuesve të këtyre operacioneve. Menaxherët e deponisë, të stacioneve të derivateve si dhe të hotelit janë përgjegjës për trajnimin, edukimin si dhe motivimin e puntorëve për të kuptuar dhe për të vepruar në pajtim me procedurat e performancës të EHS.

Kapaciteti dhe kompetenca organizative:

HIB Petrol ka një ndërlidhës korporativ për çështjet e EHS-së dhe të Burimeve Njerëzore në zyrat qendrore. Menaxherët e hotelit, deponisë si dhe të stacioneve të derivateve kanë ekipet e tyre operuese për të menaxhuar çështjet e EHS-së në secilin objekt, çështje për të cilat ata raportojnë çdo muaj në zyrën qendrore të ndërlidhjes

Monitorimi dhe rishikimi:

HIB Petrol ka një qendër të kontrollit të operacioneve për biznesin e karburanteve i cili ka qasje në të gjitha vendet kritike të deponive të stacioneve të derivateve përmes televizionit me qark të mbyllur. Qendra e kontrollit ka mundësi të flas me të gjithë menaxherët në detyrë si dhe me shoferët e cisternave për menaxhime operacionale rutinore apo për përgjigje emergjente.

HIB Petrol mban të dhënat e performancës sociale dhe mjedisore përmes strukturës së raportimit intern, ndërsa çështjet e rëndësishme të E&S diskutohen në mbledhje javore të menaxhmentit të korporatës. Për takime mujore të menaxherëve çdo menaxher duhet të raportoj performancat e E&S. Të gjitha mospërputhjet e identifikuar regjistrohen si dhe dërgohen për zbatim. Menaxhmenti i korporatës në mënyrë periodike inpekton të gjitha objektet. Mospërputhjet e identifikuar regjistrohen në planet për veprim korrigjues si dhe ndiqen në detaje nga menaxhmenti në inspektimet e ardhshme.

Si pjesë e projektit HIB Petrol është duke punuar njëkohësisht për të krijuar një bazë të dhënash intranet për të përmirësuar performancat e EHS-së dhe të Burimeve Njerëzore në dokumentim dhe raportim.

Për deponinë e karburanteve dhe stacione e karburanteve aktualisht nuk ka programe monitorimi për cilësinë e ajrit në ambientin e punës. Siç tregohet në ESAP HIB Petrol do të fillojë monitrimin e niveleve të benzinës dhe të propanit në deponi si dhe në secilin stacion të derivateve për cilësinë e ajrit si dhe mjedisit të punës.

Përgatitja dhe reagimi në raste emergjente:

HIB Petrol posedon rregullorë të parandalimit të zjarrit dhe të reagimit ndaj emergjencave (ER) i thurur për bizneset e karburanteve dhe hoteleve. Ekipet e zjarrfikësve ndodhen pranë deponisë së karburanteve dhe janë në gjendje gatishmërie në rast të nevojës së intervenimit. Paisjet zjarrfikëse janë të instaluar me sistemin përkatës të ftohjes dhe spërkatjes në të gjitha stacionet e derivateve. Siç tregohet në ESAP, HIB Petrol do të instaloj sistemim zjarrfikës me shkum në deponi. Në rast të nevojës ekipet me kamion të fikjes së zjarrit mund të arrijnë në secilën prej pikave të HIB-it brenda periudhës kohore prej 5 deri në 10 minuta. Në deponinë e karburanteve si dhe në stacionet e karubranëve mbahen trajnime vjetore zjarri. Si pjesë e projektit HIB do të rrisë frekuencën e trajnimeve ndaj zjarrit në baza tremujore për deponinë si dhe 6 mujore për stacionet e benzinës.

Hoteli i HIB ka gjithashtu planin e vet të trajnimit ER për shurajen e zjarrit si dhe të evakuimit dy herë në vit. Trajnimet e evakuimit gjithashtu përfshijnë klientët e hotelit. Dy brigada zjarrfikëse lokale janë respektivisht 2 dhe 4 km larg nga hoteli.

PS 2 – Puna dhe kushtet e punës

HIB Petrol aktualisht ka të punësuar 770 punonjës dhe planifikon të punësojë rreth 150 punonjës të ri për projektin e zgjerimit. Një numër i papërcaktuar i punonjësve do të punësohen për ndërtimin, respektivisht ekzekutimin e planin zgjerues përmes kontraktorëve.

Politika dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore:

HIB Petrol ka një politikë korporative të Burimeve Njerëzore që specifikon termet dhe kushtet e punësimit. Këto përfshijnë procedura lidhur me rekrutimin, trajnimin, rishikimin e performancës, promovimin, sigurimin, pagën dhe kompenzimin, dorëheqjen, pushimin nga puna, pushmet vjetore apo pushimet e tjera si dhe daljen në pension. Kompania ofron trajnime rreth politikave dhe procedurave të Burimeve Njerëzore si pjesë e induksionit të puntorëve të rinj, politik tek e cila kanë qasje që të gjithë. HIB Petrol është i përkushtuar të operoj kundrejtë standardve të performancës 2 (PS2) të IFC-së për kërkesat e punës. Përmes dokumentacionit, kontratës dhe inspektimit HIB do të kërkoj nga kontraktuesit e ndërtimeve që të veprojnë kundrejtë rregullorës së IFC-së PS2 në lidhje me kushtet e punës dhe të jetesës në vendet e ndërtimit.

Kushtet e punës:

Të gjithë puntorët e HIB Petrol janë të vendosur në listën e pagave si puntorë afatgjatë dhe nuk ka puntorë të përkohshëm. Të gjitha kontratat janë të rregulluara në mënyrë strike përkitazi ligjit të punës dhe puntorët janë të punësuar me kontrata me kohëzgjatje të caktuar me mundësi vazhdimi varësisht nga performanca e tyre dhe prania e tyre në punë. Puna pas orarit të paraparë është e pazakontë dhe ndodh vetëm në raste të emergjencave. Puna jashtë orarit në fundjavë dhe gjatë festave kompenzohet me bazë 1.5 deri në 2 herë të pagës bazë. Paga mesatare në HIB është më e lartë se paga e industrive të ngjashme.

Organizata e puntorëve:

Në HIB Petrol nuk ka asnjë sindikatë të pavarur të puntorëve. Menaxhmenti nuk ka kufizime ndaj bashkimit të puntorëve dhe lejon negociata kolektive.

Mosdiskrimini dhe mundësia e barabartë:

Politika e Burimeve Njerëzore artikulon angazhimin e kompanisë ndaj mosdiskriminimit si dhe mundësive të barabarta. Nuk është identifikuar asnjë procedurë apo praktikë diskriminuese gjatë vizitave në terren. Të gjitha punësimet janë të bazuar në merita, raca dhe feja nuk mirren parasysh në shqyrtimin e punësimit. Aktualisht 15% e puntoreve janë femra. Siç tregohet në ESAP, HIB do të zhvilloj një program për të punësuar më shumë punonjëse femra në projektin e zgjerimit.

Shkurtime/Pakësimi:

Meqenëse kompania është duke i rritur operacionet nuk pritet që të ketë pakësim.

Mekanizimi i ankesave:

Mekanizmi i ankesave është futur gjatë induksionit të punonjësve të rinjë. Të gjithë puntorët mund të raportojnë ankesat e tyre tek menaxherët e burimeve njerëzore. Të gjitha ankesat dhe zbutjet regjistrohen, nëse menaxheri i burimeve njerëzore nuk mund të zgjidh ankesën atëherë duhet të raportoj tek menaxhmenti i lartë. Email adresa e Burimeve Njerëzore si dhe kutia e ankesave/sugjerimeve janë në dispozicion për të gjithë për ankesa anonime.

Mbrotja e fuqisë puntore:

HIB Petrol vepron në përputhje me ligjin e punës dhe nuk punëson puntorë nën moshën 18 vjeçare. Gjatë procesit të punësimit HIB Petrol kontrollon çertifikatat e lindjes dhe të shkollës. Në HIB Petrol nuk praktikohet asnjë metodë e punës së detyruar.

Shëndeti dhe siguria në punë:

HIB ka procedura OHS për detyra dhe aktivitet të ndryshme duke përfshirë rregullat për përdorim e paisjeve mbrojtëse personale (PPE) dhe ato që lidhen me përdorimin e materialeve të rrezikshme, puna në lartësi apo në vende të mbyllura. Procedurat e OHS-së zbatohen në mënyrë rigorozë dhe normat e aksidenteve të OHS-së janë në përputhje me praktikën e mira të industrisë internacionale (GIIP). Në historinë e HIB Petrol asnjëherë nuk ka pasur aksidente fatale apo serioze. Trajnimi i OHS-së është pjesë e re e induksionit të puntorëve. Si pjesë e projektit HIB Petrol do të zbatohet edhe trajnime vjetore për ripërtrijen e të punësuarve në deponin e karburanteve si dhe në stacione e derivateve, të gjithë puntorët duhet të kalojnë provimet e induksioneve vjetore për të qenë në gjendje të punojnë në deponi dhe në stacionet e derivateve. Siç është përshkruar më lartë, HIB do të sigurojë menaxhimin adekuat të OHS-së nga kontraktorët e ndërtimit.

PS 3 – Eficienca e Burimeve dhe Parandalimi i ndotjes

Burimi dhe eficientia e lëndëve të para:

Burimet e konsumuara në këtë projekt janë kryesisht energjia elektrike dhe uji në biznesin e hotelit, ndërsa konsumimi i burimeve për deponinë, shitjen me shumicë dhe pakicë janë të limituara. Furnizimi me ujë kryhet nga komuna ndërsa furnizimi me energji elektrike blihet nga rrjetet lokale. Menaxhmenti i hotelit të HIB Petrol ka programe të ndryshme për të reduktuar konsumimin e burimeve. Norma e konsumimit (m³/mysafir/natë) dhe niveli i konsumit të energjisë (hapsira e shërbimit kWh/m²) i plotësojnë standardet e udhëzuesit të Direktivave të WBG WHS.

Përmbushja e shkarkimeve dhe emisionit:

Ujërat e zeza nga deponia dhe stacionet e derivateve shkarkohen në sistemin komunal të ujërave të zeza për trajtim. Ujërat e zeza nga hoteli i tanishëm si dhe nga zgjerimi në të ardhmen janë tipike ujëra të zeza shtëpiake dhe HIB Petrol e ka të lejuar që ti shkarkoj në sistemin komunal të ujërave të zeza për trajtim të mëtutjeshëm impiant për trajtimin e ujërave të ndotura. Uji i ndotur i shiut në stacionet e derivateve mblidhet për ndarjen e vajit para se të shkarkohet. Mbetjet e ujërave nga pastrimi i makinave fillimisht filtrohen në vend para se të derdhen në sistemin komunal të ujërave të zeza. Meqenëse nuk ka procese të prodhimit HIB Petrol nuk ka burim emisionesh. HIB Petrol nuk ka të instaluar sisteme për rimëkëmbjen e avujve për deponinë e karburanteve apo në stacionet e naftës. Emetimet fugitive janë të prodhura nga procesi i mbushjes së benzinës. Siç kërkohet në ESAP, HIB Petrol do të instaloj sisteme për rimëkëmbjen e avullit në deponi dhe si pjesë e projektit këto do të inkorporohen edhe në stacione e derivateve ekzistuese si dhe ato që pritet të ndërtohen në të ardhmen.

Menaxhimi i derivateve:

Deponia e derivateve si dhe stacionet e derivateve janë të ndërtuara në toka jo-industriale në të cilat nuk ka ndotje historike. Për zgjerimet e ardhshme HIB Petrol planifikon të blejë vetëm pjesë të vogla të tokës bujqësore për të shmangur kontaminimin historik. Të gjitha tanket nëntokësore kanë shtresa të dyfishta të çelikut ato gjithashtu kanë një mburojë sekondare me vëllim të mjaftueshëm mbajtës për rezervuarët për ruajtje nëntokësore në depo. Valvolat, lidhjet dhe tokëzimet elektrike për të gjitha tanket kontrollohen çdo muaj nga stafi i HIB Petrol. Në çdo të pestin vit kompani të autorizuar nga jashtë kontraktohen me qëllim të kontrollimit dhe pastrimit të tankeve. Pastrimi dhe kontrolli i fundit është bërë në vitin 2016, ndërsa të gjitha ngarkimet dhe shkarkimet kontrollohen në mënyrë automatike. LPG i avulluar gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit është i ngjeshur/ i lëngëzuar dhe i tubuar përsëri në rezervuarë.

Menaxhimi i Hotelit

Punonjësit e kuzhinës së hotelit kanë kontroll fizike vjetore dhe deri më tani nuk ka pasur aksidente të helmimit me ushqim. Në hotel ka vetëm shërbime lavanderie ndërsa tharja është e nënkontraktuar. Menaxhimi i pesticideve bëhet nga një kompani internacionale e nënkontraktuar për kontrollimin e dëmtuesve. Sipas kontratës, janë të lejuar vetëm pesticidet që janë miqësore për mjedisin, HIB gjithashtu posedon fletë të të dhënave të sigurisë materiale të të gjitha pesticideve të përdorura. Gjithmonë ka punonjës në dispozicion tek pishina e hotelit dhe kualiteti i ujit të pishinës monitorohet çdo dy orë. Si pjesë e këtij projekti HIB do të zbatojë programin e monitorimit të komponentëve organike të paqëndrueshme (VOCs) për hotelin.

Gzërat serë (GHG):

HIB përafërsisht gjeneron 12,000 ton CO₂ ekuivalente për një vit në fazën e tanishme apo 18,000 ton pas implementimit të projektit, kryesisht nga konsumimi i hotelit dhe deponis-stacioneve të derivateve.

PS 4- Siguria e shëndetit dhe komunitetit

Depoja e karburanteve ndodhet në një zonë rurale të pa banushme . Stacionet e derivateve janë të vendosura përgjatë autostradave kryesore. Operacione e stacioneve të derivateve si dhe të deponisë kanë ndikime të kufizuara në komunitetet e largëta.

Në kuadër të departamenteve të tjera në HIB Petrol funksionon edhe departamenti i logjistikës. Të gjitha cisternat rrugore janë të prodhura në Europen Perëndimore me standarde dhe karakteristika për cisternat e karburantëve duke përfshirë sistemin për ndjekje GPS. Sistemi i transportit në HIB në mënyrë rigoroze ndjekë kornizën e Marrëveshjes Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtarë të Mallrave të Rrezikshme nga Rruga. Të gjithë shoferët janë të çertifikuar nga ADR dhe rinovohen çdo pesë vjetë. Sipas ADR-së të gjithë tankerët e rrugëve inspektohen çdo vit në tërësi dhe kalojnë në mirëmbajtje të specifikuar për çdo 15,000 km.

Për tu siguruar se sistemi i transportit të HIB Petrol është në përputhje me kërkesat e ADR kryhen kontrollat të jashtme periodike. Të gjithë shoferëve të kamionëve kërkohen të kryejn trajnimet e nevojshme dhe të kenë liçencat e vlefshme siç kërkohet nga ADR. Të gjithë punonjësve u kërkohen të kenë kontrollë vjetore mjekësore. Ekzistojnë 30 minuta informacione të përditshme të sigurisë për të gjithë shoferët dhe 15 minuta të sigurisë për stafin e deponisë dhe stacioneve të derivateve.

Menaxhimi i sigurisë së jetës dhe zjarrit në hotel:

Elementet e sigurisë së jetës dhe nga zjarri përfshihen në hotelin ekzistues. Detektorët e tymit dhe spërkatësit janë të vendosur në të gjitha dhomat dhe sallat e konferencave. Në çdo kat ka hidrantë zjarri dhe dalje emergjente. Në përputhje me ESAP, HIB Petrol do të kontraktojë ekspert të jashtëm për të përgatitur Planin e Sigurisë së Jetës dhe Zjarrit (L&FS) dhe do të sigurojë çertifikimin se sistemet L&FS për projektin e zgjerimin e hotelit do të dizajnohen, ndërtohen dhe do të operojnë në përputhje të plotë me kërkesat lokale dhe në pajtim me një standard të pranuar ndërkombëtarisht sipas kërkesve të Seksionit të L&FS të Udhëzimeve të Përgjithshme të Shëndetit Publik (WBG). Pas përfundimit të ndërtimeve ekspertët duhet të konfirmojnë se sistemet janë ndërtuar sipas dizajnit të dakorduar të L & FS.

Personeli i sigurimit:

HIB Petrol ka stafin e vet të sigurisë në depo dhe në hotel. Stafin e sigurisë nuk është i armatosur. Për çështje serioze të sigurisë HIB Petrol raporton direkt te stacionet lokale të policisë.

Angazhimi i palëve të interesuara:

HIB Petrol angazhon palët e interesuara në mënyrë aktive dhe ka takime rutinore me komunitetet e afërta. Të gjitha projektet e reja/rinovuese shpallen në gazetata lokale dhe mbahen konsultimepublike për projekte të reja. Informatat kontaktuese për ankesat e komunitetit publikohen në çdo stacion të benzinës dhe në web faqen e HIB Petrol. Cdo aneksë regjistrohet për shqyrtim

HIB Petrol ka zhvilluar një program me buxhet të specifikuar për angazhimin dhe zhvillimin e komunitetit. HIB Petrol ka një program që mbështet personat me aftësi të kufizuara duke përfshirë pushimet, festat, etj. HIB Petrol gjithashtu mbështet komunitetet lokale për aktivitete sportive dhe programe të veçanta arti.

Qasja lokale e dokumentacionit të projektit:

HIB Petrol do ta vendos këtë dokument në ueb faqen e tij në internet (www.hibpetrol.com). Për pyetje apo çdo lloj shqetësimi rreth ndikimeve mjedisore dhe sociale të këtij projekti ju lutem kontaktoni:

Personi kontaktues:	Hysen Lajqi CEO
Adresa:	Talinoc I Muhaxhereve, Ferizaj Republika e Kosovës
Email:	Hysen.lajqi@hibpetrol.com
TEL:	+38649-999987
Facsimile:	+3813877777